



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2024-03

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 shtator 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave:

Sajmon Loz

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 172 dhe 173(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), cakton Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Aktgjykimin e shqiptuar nga Trupi Gjykses I në këtë çështje në vijim të Njoftimit të Mbrojtjes për Apel ("Njoftimi për Apel").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses I lëshoi Aktgjykimin dhe dënimin me një Shtojcë Konfidenciale, ku, ndër të tjera, shpalli fajtor z. Shala për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.²

2. Më 19 korrik 2024, z. Shala kërkoi zgjatje afati për dorëzimin e Njoftimit për Apel ("Kërkesa").³

3. Më 24 korrik 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht Kërkesën dhe urdhëroi z. Shala të dorëzonte Njoftimin për Apel deri më 2 shtator 2024.⁴

¹ F00010, Njoftimi i Mbrojtjes për Apel, 2 shtator 2024.

² KSC-BC-2020-04/F00847, Aktgjykim dhe Dënim me një Shtojcë konfidenciale, 16 korrik 2024 (konfidencial), para. 1121-1123.

³ F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Mbrojtjes për Apel me Shtojcën 1 Konfidenciale, 19 korrik 2024.

⁴ F00006, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 24 korrik 2024.

4. Më 8 gusht 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi kërkesën e z. Shala për zgjatje të mëtejshme të afatit.⁵

5. Më 2 shtator 2024, z. Shala dorëzoi Njoftimin për Apel.

II. KLASIFIKIMI

6. Njoftimi për Apel është klasifikuar si konfidencial dhe për rrjedhojë ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në pajtim me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

7. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Kai Ambos

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin kundër aktgjykimit.

⁵ F00009, Vendim mbi Kërkesën e Mëtejshme të Mbrojtjes për Zgjatje Afati për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 8 gusht 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 3 shtator 2024

Në Hagë,

Holandë